

BREAKING NEWS

x

MINISTRIA PUBLIKON BILANCIN, JA SA RASTE TE REJA JANE SHENUAR 24 ORET E FU...

AKTUALITET

Tronditet kryeqyteti, atentat në kodrat e liqenit 62-vjeçarit në prani të djalit, identifikohen autorët

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
17 MARS 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një ngjarje e rëndë me pasojë vdekjen ka ndodhur mesditën e djeshme në kryeqytet. Mësohet se një 62-vjeçari, i është bërë atentat duke u qëlluar tre herë me armë zjarri. Si pasojë ka mbetur i vdekur në vend Haxhi Baçinozi, 62 vjeç. Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 18:15 në kodrat e liqenit artificial shumë pranë shkollës “Ëillson” Viktima ka qenë duke bërë vrap sëbashku me djalin e tij të mitur,

kur i është bërë pritë nga një person tashmë i identifikuar nga policia. Kur 62-vjeçarit, iu bë atentat zona ka qenë shumë e populluar, ku përveç djalit të viktimës ka pasur dhe persona të tjerë që fatmirësisht i shpëtuan plumbave. Menjëherë pas ngjarjes së rëndë forca të shumta policore shkuan aty dhe nisën hetimet për identifikimin e autorëve. Kanë qenë dëshmitarë nga vendngjarja dhe dëshmia e të miturit që kanë identifikuar autorët që i bënë atentat 62-vjeçarit. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se i moshuari është qëlluar nga shtetasi me inicialet I. H., dhe ky nga Fieri. Sipas policisë autori dhe viktima kanë pasur një konflikt të hershëm mes tyre, që për arsye hetimore policia është treguar mjaft e rezervuar për dhënien e detajeve. Referuar burimeve policore, bëhet fjalë se kanë qenë dy persona që kanë bërë atentatin, të dy nga Fieri të identifikuar me inicialet I. S., dhe I. B.. Pasi kanë qëlluar drejt objektivit të tyre ato janë larguar me një motor drejt Saukut. Pas ngjarjes policia ka ngritur menjëherë postblloqe për të kapur autoret e dyshuar të ngjarjes, ndërsa ka shoqëruar dhjetëra dëshmitarë okularë mes të cilëve edhe të birin e viktimës, i cili ka parë të gjithë skenën e krimit, ky i fundit ka identifikuar dhe autorët e dyshuar të vrasjes së babait të tij.

Hetimet

Zyrtarisht, Policia e Tiranës tha dje se është identifikuar autori i ngjarjes dhe është duke u punuar për arrestimin e tij. Burime thonë se ka dyshime se ai është larguar me anë të një mjeti në drejtim të Saukut, megjithëse ende nuk është bërë i mundur arrestimi i tij. Ndërkohë, policia dhe grupi i posaçëm hetimor, i ngritur për zbardhjen e vrasjes, është duke kryer veprimet e para hetimore dhe kanë bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes. Burime shprehen të rezervuara në lidhje me motivin e kësaj ngjarje, që tronditi kryeqytetin pasditen e djeshme, duke thënë se është duke u punuar edhe në këtë drejtim, pasi ende nuk janë të qarta rrethanat. Ndërkohë, përpos ekspertimit të vendit të ngjarjes, hetuesit kanë marrë edhe dëshmi të

personave që kanë në vendin e ngjarjes. Gjithashtu, burime nga grupi hetimor thanë se autori u ndihmua nga një person tjetër për tu larguar nga vendi i ngjarjes. E gjitha zona e Liqenit Artificial u rrethua dhe nga policia, e cila ushtroi edhe kontrole, me qëllimin e gjetjes së ndonjë prove të vlefshme për zbardhjen e ngjarjes dhe kapjen e autorëve.

Kush është viktimë

Haxhi Baçinozi, i cili u ekzekutua pasditen e djeshme në kodrat e liqenit artificial me tre plumba nga një person tashmë i identifikuar nga policia është ish i përndjekur politik. Autori u largua nga vendi i ngjarjes me motor i ndihmuar nga një tjetër person edhe ky i identifikuar. Mësohet se 62-vjeçari, nga Mallakastra është dënuar nga sistemi komunist me dy dënime. Më konkretisht viktimë ka qenë i dënuar me 10 vite burg për agjitacion dhe propagandë dhe me 21 vitet për veprën e terrorit. Mësohet se më 30 janar 1982, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «agjitacion e propagandë». U dënua sërish më 3 qershor 1984, kësaj radhe me 21 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «veprën e terrorit në bashkë-punim» (dënim i kombinuar). Lidhur me ngjarjen e djeshme policia ka identifikuar autorët e atentati, të cilët sipas policisë janë identifikuar me inicialet I. H., dhe I. M., të dy nga Fieri. Policia është vënë në ndjekje dhe po punon për kapjen e tyre. Nuk dihen shkaqet e vrasjes së Baçinozit, por burimet thonë se ai ka pasur një konflikt të hershëm me autorët. Policia e kryeqytetit po punon për zbardhjen e konfliktit që viktimë mund të ketë pasur me autorët e kësaj ngjarje të rëndë, ku si pasojë mbeti i vdekur 62-vjeçarit. Ngjarja e rëndë ndodhi dhe pasdite rreth orës 18:15, tek Liqeni Artificial, ndërsa Baçintozi kishte dalë për vrap bashkë me djalë të tij.